



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Janar, 2020

Kishte pranuar qindra kërkesa nga sindikalistët tanë

Avokati i Popullit ka proceduar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën e anëtarësisë së SBASHK-ut



Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudsmana Republike Kosovo
Ombudsperson Institution of Republic of Kosovo

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e përkohshëm të Ligjit të pagave, anëtarësia e SBASHK-ut kishte nisur përmes shoqatave sindikale dhe nivelit komunal sindikal të mbledh nënshkrime dhe t'i drejtohet Avokatit të Popullit me kërkesën që Ai, pas shqyrtimit të çështjes, ta procedojë në Kushtetuese kërkesën e tyre për revokimin e vendimit për masën e përkohshme të ... (faqe 4)

Avokati i popullit u takua me përfaqësuesit e 5 sindikatave

Bashkëbisedë për qindra kërkesat e anëtarësisë drejtuar këtij institucioni



Avokati i popullit, z. Hilmi Jashari duke iu përgjigjur një kërkesë të përbashkët të... (faqe 6)

Mësimdhënësit nga shtete të botës në ceremoninë përkujtimore në Aushvic

Delegacioni i SBASHK-ut mes kolegëve sindikalistë nga 17 shtete të botës




Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës... (faqe 7)

Intervistë me mësimdhënësen, Minire Tërbunja

Trajnimet një ndihmesë e madhe e SBASHK-ut për anëtarësinë

Minirja është mësimdhënëse e lëndës Gjuhë Shqipe...
(faqe 3)



Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës mbështet SBASHK-un

ETUCE u drejton letra institucioneve lidhur me Ligjin e pagave

Komiteti i Sindikatës Evropiane të Arsimit (ETUCE), me seli në Bruksel është informuar nga SBASHK-u.... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Sfidë pas sfide



E vlerësuam si mjaft të vështirë e me plot sfida vitin 2019 dhe bashkërisht uruam që në vitin 2020 të krijohen sa më pak shqetësime, por nuk po ndodh kështu. Shqetësimi i parë i përcjellë edhe me zhgënjim të arsyeshëm ishte hapi që bëri Avokati i popullit për të dërguar në Kushtetuese Ligjin për pagat dhe ndodhi edhe vendimi për pezullimin e përkohshëm të këtij ligji deri në fund të marsit 2020. Punëtorët e arsimit kishin pritur me arsyë se do të merrnin pagat bazuar në koeficientet e Ligjit të pagave, por kjo nuk ndodhi. Ata arsyeshëm shprehen zhgënjimin duke organizuar një grevë dyorëshe dhe pastaj në mënyrë spontane lindi ideja që të përgatiten kërkesat adresuar Qeverisë së Kosovës dhe Avokatit të popullit që ata të kërkojnë revokimin e vendimit për masën e përkohshme të pezullimit të Ligjit të pagave. Qindra kërkesa u përgatiten anë e kënd Kosovës dhe ju dresuan edhe Qeverisë edhe Avokatit të popullit.

Kjo sfidë doli të jetë më e vogël karshi deklarimeve se në mungesë të institucioneve mund të vij deri të situata kur nuk do të ketë Ligj të aprovuar të buxhetit dhe me këtë edhe të mos ketë paga nga marsi e tutje. SBASHK bashkë me FSSHK-në dhe Sindikatën e Policisë kërkuar takime urgjente me Kryeministrin në detyrë, z. Ramush Haradinaj dhe me Kryetarin e Parlamentit, z. Glauk Konjufca e me Avokatin e popullit, z. Hilmi Jashari.

Ndodhën takimet me kryeparlamentarin Konjufca dhe me Avokatin e popullit dhe u bisedua shtruar me kryetarin e Parlamentit për shqetësimin që në mungesë të aprovimit të buxhetit do të krijohet një situatë e tendosur në të gjithë sektorët, ndërsa me z. Jasharin u bisedua për kërkesat që ai t'i drejtohet Kushtetueses lidhur me heqjen e masës së përkohshme të pezullimit të Ligjit të pagave. SBASHK-u bashkë me Sindikatën e Shëndetësisë, atë të Policisë, Doganës e Zjarrfikësve do të vazhdojnë me angazhimet e përbashkëta për të gjetur zgjidhje të duhura e në shërbim të anëtarësisë. Nëse bazohemi në thënien e njohur të popullit se dita e mirë shihet në mëngjes, atëherë edhe viti 2020 nuk do të jetë pa sfida për sindikatat.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimit Sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383 (0) 38 - 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen, Minire Tërbunja

Trajnimet një ndihmesë e madhe e SBASHK-ut për anëtarësinë



Minirja është mësimdhënëse e lëndës Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në Shkollën e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri. Ajo ka punuar me përkushtim në disa nga mediet në Kosovë dhe tani është e angazhuar edhe nga SBASHK-u për trajnimin “Edukim medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe

demokratik”. Ajo profesionin e mësimdhënësit e vlerëson si të vështirë, por shton se me punë, përkushtim dhe angazhim mund të arrihen të gjitha.” Përveç që mësimdhënësit përfitojnë njohuri të reja që ofrojnë trajnimet, anëtarët e SBASHK-ut, janë njoftuar edhe me shumë informata të duhura për të drejtat e mësimdhënësve dhe sfidat dhe arritjet e SBASHK-ut”, flet ajo për vlerën dhe rëndësinë e trajnimeve që organizon SBASHK-u.

Arsimimi sot:

Kush është Minire Tërbunja?

Minirja:

Kam lindur në fshatin Turiqec në komunën e Skenderajt. Shkollën fillore dhe të mesme e kam përfunduar në Turiqec. Studimet kam mbaruar në Fakultetin e Filologjisë dega Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në Universitetin e Prishtinës. Për dhjetë vite kam punuar gazetares në mediat e shkruara të Kosovës. Kam filluar në agjencinë e lajmeve Kosoalive, pastaj kam vazhduar në gazetën ditore “Epoka e re”, si dhe kam bashkëpunuar me revista tjera, kryesisht në rubrikën e kulturës. Nga viti 2010 jam mësimdhënëse e lëndës Gjuhë Shqipe edhe Letërsi në Shkollën e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi”, në Vushtrri. Kohëve të fundit jam e angazhuar edhe në trajnimet e organizuara nga SBASHK-u, trajnere në trajnimin “Edukim Medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik”.

Që nga fillimi i punës sime në arsim jam anëtare e SBASHK-ut. Jam e martuar dhe jam nënë e tre fëmijëve Bledarit, Valbonit dhe Valtonit.

Arsimimi sot:

Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënëses sot?

Minirja:

Mendoj se është e vështirë puna e mësimdhënësit, por me punë, përkushtim dhe angazhim mund të arrihen të gjitha. Edhe pse puna e mësimdhënësit kërkon përgatitje të lartë profesionale, sidomos sot që jemi në kohën e teknologjisë dhe burim i informatave më nuk është vetëm mësuesi dhe libri, siç ka qenë me parë.

Arsimimi sot:

Si ndiheni si trajnere e SBASHK-ut?

Minirja:

Me organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve nga SBASHK-u është bërë një punë e mirë për mësimdhënësit. Këto trajnime kanë qenë të mirëseardhura edhe për mësimdhënësit e shkollës teknike “Lutfi Musiqi”. Jemi shkolla e parë nga të gjitha komunat e Kosovës që kemi filluar me trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike”, si dhe me trajnimet e tjera të organizuara nga sindikata.

Përveç që mësimdhënësit përfitojnë njohuri të reja që u ofrojnë trajnimet, anëtarët e SBASHK-ut, janë njoftuar edhe me shumë informata të duhura për të drejtat e mësimdhënësve dhe sfidat e arritjet e SBASHK-ut. Është nder dhe krenari të jesh në mesin e anëtarëve dhe trajnerëve të SBASHK-ut, të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre po arrijnë të ofrojnë njohuri për mësimdhënësit në çdo cep dhe në çdo komunë të Kosovës. Angazhimi im në punën e trajneres për “Edukim medial” është një përvojë e mirë, sepse ky trajnim është i domosdoshëm në kohë të cilën jetojmë. Përmes trajnimit, mësimdhënësit fitojnë përgatitje më të mirë në edukim medial. Ata aftësohen në përdorimin e drejtë të medieve.

Arsimimi sot:

Si e vlerësoni profesionin e mësueses sot?

Minirja:

Duke filluar nga disa këshilla për mësuesit, nga gjuhëtari ynë, Eqrem Çabej, se mësuesia nuk është



profesion, ajo është mision, profesioni i mësimdhënësit është profesioni më i shenjtë nga gjithë profesionet e tjera.

Nga viti 2010 që kur unë punoj në këtë profesion kanë kaluar disa gjenerata, dhe nxënësit e shkollës sonë sot janë në të gjitha profesionet dhe unë ndihem krenare me të arriturat e tyre. Megjithatë ende kemi vështirësi që paraqiten në krijimin e kushteve në shkollat tona, si mungesa e pajisjeve teknologjike e shumë vështirësi të tjera.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut?

Minirja:

Aktivitete të SBASHK-ut ka shumë, mirëpo dua të theksoj se si e arritur e madhe është zbatimi në pjesën më të madhe të Kontratës Kolektive. Pjesëmarrja në

hartimin e ligjit të pagave. Përkushtim i jashtëzakonshëm i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Ka shumë mësimdhënës kanë mbajtur trajnime në të gjitha komunat e Kosovës. Anëtarësimi në Internacionalen Botërore të Arsimit (EI) . Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, aprovimin e ligjit për mësimdhënësit e viteve '90 e shumë të arritura të tjera.

Arsimimi sot:

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta?

Minirja:

SBASHK-ku të vazhdojë të mbrojë dinjitetin e mësimdhënësit. SBASHK-u është shembulli më i mirë në mbrojtje të anëtarësisë së mësimdhënësit.

Gjatë muajit

Kishte pranuar qindra kërkesa nga sindikalistët tanë

Avokati i Popullit ka proceduar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën e anëtarësisë së SBASHK-ut

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e përkohshëm të Ligjit të pagave, anëtarësia e SBASHK-ut kishte nisur përmes shoqatave sindikale dhe nivelit komunal sindikal të mbledh nënshkrime dhe t'i drejtohet Avokatit të Popullit me kërkesën që Ai , pas shqyrtimit të çështjes, ta procedojë në Kushtetuese kërkesën e tyre për revokimin e vendimit për masën e përkohshme të pezullimit të Ligjit të Pagave.

Avokati i Popullit ka njoftuar se kërkesa e institucioneve arsimore komunale të arsimit, e nënshkruar nga anëtarët e Sindikatës së Bashkuar të

Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), drejtuar Avokatit të Popullit, për revokimin e Vendimit nr. KO 219/19 për masën e përkohshme të Gjykatës Kushtetuese, i datës 12 dhjetor 2019, lidhur me pezullimin e përkohshëm të Ligjit të pagave, është proceduar në Gjykatën Kushtetuese. SBASHK-u shpreh respekt për këtë angazhim të Avokatit të Popullit.

Po ashtu SBASHK-u , Sindikata e Shëndetësisë , Policisë, Doganës dhe Zjarrfikësve janë në përfundim të përgatitjes së një shkresë të përbashkët për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese në emër të anëtarësisë së tyre e që ka të bëjë me kërkesën për revokimin e vendimit për masën e përkohshme të pezullimit të Ligjit të pagave. Kjo shkresë Kushtetueses do t'i dorëzohet së largu të premten e kësaj jave.



Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudsmana Republike Kosovo
Ombudsperson Institution of Republic of Kosovo

Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës mbështet SBASHK-un ETUCE u drejton letra institucioneve lidhur me Ligjin e pagave

Komiteti i Sindikatës Evropiane të Arsimit (ETUCE), me seli në Bruksel është informuar nga SBASHK-u lidhur me situatën e re në sektorin e arsimit të Kosovës pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila duke aprovuar kërkesën e Avokatit të popullit, pezulloi Ligjin e pagave deri më 30 mars 2020.

SBASHK-u duke përcjellë shqetësimin e thellë dhe zhgënjimin e arsyeshëm të gjithë anëtarësisë që ishin në pritje tani e 9 muaj për implementimin e Ligjit të pagave, ka informuar ETUCE-n se në gjithë shoqatat sindikale janë duke u mbledh nënshkrime, të cilat po i dorëzohen Qeverisë së Kosovës dhe Avokatit të popullit me kërkesën që ata, duke respektuar kërkesën legjitime të mijëra punëtorëve të arsimit, t'i drejtohen Kushtetueses me kërkesën që të revokojë vendimin për masën e përkohshme të pezullimit të Ligjit të pagave.

Komiteti i Sindikatës Evropiane të Arsimit përmes Drejtores së përgjithshme Suzan Flocken i është drejtuar me një letër Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Avokati të popullit, Hilmi Jashari dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës duke kërkuar që ata ta kenë parasysh këtë kërkesë legjitime të punëtorëve të arsimit dhe duke kujtuar edhe një herë se Komiteti i Sindikatës Evropiane për Arsim (ETUCE), që përfaqëson 132 sindikata arsimore, gjegjësisht 11 milion mësues në Evropë, është në mbështetje të SBASHK-ut.

“Organizata jonë anëtare SBASHK ka përcjellë shqetësimin e saj të thellë për vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të 12 dhjetorit 2019 që është dhënë në bazë të kërkesës së Avokatit të Popullit të Kosovës dhe që pezullon përkohësisht Ligjin e Pagave të Sektorit Publik deri më 30 mars 2020. Pas kësaj, ETUCE i shpreh mbështetje SBASHK-ut dhe ju kërkon të filloni bisedime që përfshijnë Kryeministrin në detyrë dhe të gjithë drejtuesit e partive politike për të diskutuar alternativat e mundshme për alokimin e

25% të rritjes së pagave, siç u përcaktua fillimisht nga Ligji i pagave të sektorit publik. Ju sigurojmë se do të vazhdojmë të vëzhgojmë nga afër zhvillimet”, thuhet veç tjerash në letrën e ETUCE drejtuar Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Avokati të popullit, Hilmi Jashari dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.



Education internationale
internationale de l'éducation
international de la Education
<http://www.ei-ia.org>

EUROPEAN REGION-
ETUCE

President
Christine BLOWER

Vice-Presidents
Odile CORDELLIER

Andreas KELLER

Trudy KERPERIEN

Doris LANGE

Galina MERKULOVA

Branimir STRUKELJ



5, Bd du Roi Albert II, 0th
1210 Brussels, Belgium
Tel +32 2 224 06 91/92
Fax +32 2 224 06 94
secretariat@etuce-etuce.org
<http://www.etuce-etuce.org>

European Director
Susan FLOCKEN

Treasurer
Mike JENNINGS

ETUCE
European Trade Union Committee for Education
EI European Region

To: Mr Hashim Thaçi

President of Kosovo¹

E-mail: hashim.thaci@rks-gov.net

protocol@president-ks.gov.net

bekim.colaku@president-ks.gov.net

Mr Hilmi Jashari

Ombudsperson for Kosovo

E-mail: hilmi.jashari@oik-rks.org

info.oik@oik-rks.org

CC:

Government of Kosovo

E-mail: zbp.zbm@rks-gov.net

Mr Ibrahim Jashari

President of SBASHK

E-mail: sbashk2004@yahoo.com

Brussels, 8 January 2020
Ref.: ST/16/10236

Subject: Solidarity with The Union of Education, Science and Culture of Kosovo (SBASHK),
ETUCE member organisation in Kosovo

Dear President,
Dear Ombudsperson,

The European Trade Union Committee for Education (ETUCE) represents 132 education trade unions i.e. 11 million teachers in Europe. As a recognised Social Partner in education at EU level, ETUCE meets at regular intervals with the European Federation of Education Employers (EFEE) in the frame of the European Sectoral Social Dialogue Committee for Education to negotiate and discuss education and employment topics relevant to teachers, academics and other education personnel in education. ETUCE is a European Trade Union Federation within ETUC, the European Trade Union Confederation. ETUCE is also the European Region of Education International (EI), the global federation of education trade unions.

Our member organisation SBASHK has conveyed its deep concern about the Kosovo Constitutional Court's decision of 12 December 2019 that was issued on the basis of the request of the Ombudsman of Kosovo and that temporarily suspends the Law of Public Sector Salaries until 30 March 2020.

Following this, ETUCE expresses its support with SBASHK and asks you to initiate talks involving the Prime Minister on duty and all the leaders of the political parties to discuss the possible alternatives to the allocation of 25 % of salary increase as it was initially determined by the Law of Public Sector Salaries.

¹ This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.



ETUCE shares the concerns of SBASHK stressing that the Court decision has already caused a financial cut of around 7.5 million Euro to the education sector and asks the Government of Kosovo to maintain permanent and effective social dialogue with social partners with a view to further contribute to a system of quality education in Kosovo.

ETUCE stands firmly with its member organisation SBASHK and expects that you relaunch the talks with the education social partners.

We assure you that we will continue to closely monitor the developments.

Yours Sincerely,

S. Flocken

Susan Flocken
European Director



SBASHK, FSSHK dhe SPK në ambientet e Parlamentit të Kosovës

Takim me Kryeparlamentarin Glauk Konjufca

Kryetari i Parlamentit të Kosovës, Glauk Konjufca duke iu përgjigjur kërkesës së tri sindikatave është takuar me përfaqësuesit e tyre për të dëgjuar nga afër shqetësimet e anëtarësisë që ata përfaqësojnë.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, i Sindikatës së Shëndetësisë Blerim Syla dhe kryetarja e Sindikatës së Policisë, Valbona Kamberi, pasi kanë falënderuar kryeparlamentarin për përgjigjen e shpejt, kanë shprehur shqetësimet e tyre në emër të mijëra anëtarëve që përfaqësojnë duke kujtuar se pas zhgënjimit që ndodhi lidhur me ligjin e pagave, nëse ndodh që të mos ketë as Ligj të buxhetit dhe procedim të pagave, atëherë situata do të jetë tepër e tensionuar dhe mund të ndodhin edhe veprime e reagime nga më të ndryshmet.

“Shumica e të punësuarve në këta sektor jetojnë nga paga e tyre dhe do të jetë të paparashikueshme reagimet e tyre nëse mbesin fare pa paga, aq më keq kur shumica janë edhe në kredi në bankat e ndryshme”, kanë alarmuar përfaqësuesit e SBASHK-ut, FSSHK-së dhe SPK-së.



Kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca ka deklaruar se mirëpret komunikimin dhe takimet me sindikatat duke vlerësuar se me angazhime të përbashkëta e me dialog të sinqertë mund të shënohen arritje në shërbim të të punësuarve në të dy sektorët.

“Shqetësimin që po e ngritni ju është edhe shqetësim imi. Kam shqyrtuar me ekspertë mundësitë eventuale që Kosova ta ketë Ligjin e buxhetit për vitin 2020 për të mos ardhur në situatën e mbetjes pa paga të mijëra të punësuarve në sektorë të ndryshëm, por në situatën aktuale mundësitë për të pasur një Ligj të buxhetit janë të vogla. Unë do të bëj gjithë angazhimet që në bashkëpunim me gjithë palët tjera për të gjetur një zgjidhje të lejuar ligjërish”, është shprehur Konjufca.

Avokati i popullit u takua me përfaqësuesit e 5 sindikatave

Bashkëbisedë për qindra kërkesat e anëtarësisë drejtuar këtij institucioni



përbashkët të SBASHK-ut, Sindikatës së Shëndetësisë, Policisë, Doganës dhe Zjarrfikësve, është takuar me ta dhe ka dëgjuar me kujdes shqetësimet e ngritura. Përfaqësuesit e këtyre sindikatave kanë kujtuar se në adresën e Avokatit të popullit janë drejtuar qindra shkresa me kërkesën që ai t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese që ajo të bëjë

revokim të vendimit lidhje me pezullimin e përkohshëm të ligjin e pagave.

Në këtë takim Avokati i popullit është shprehur nuk ka qenë kërkesa e tij për ndërhyrje në aneksin tre të Ligjit të pagave respektivisht ndryshimit të koeficienteve por ka kërkuar nga Gjykata kushtetuese kushtetutshmërinë e disa neneve të këtij ligji. Ai po ashtu ka shprehur mendimin se këto sindikata mbase duhet t'i drejtohen Kushtetueses me këtë kërkesën që ajo të revokojë vendimin për masën e përkohshme të pezullimit të Ligjit të pagave, masë kjo e vendosur më 12 dhjetor 2019 .

Pas takimit me Avokatin e popullit këto sindikata kanë vazhduar me konsultimet dhe me takimet e përbashkëta për t'u pajtuar që bashkërisht të përgatitin shkresën adresuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën e vetme që Gjykata të merr në konsideratë brengën e mbi 60.000 të punësuarve në sektorin publik. Kërkesa ka të bëjë me revokimin e

vendimit të lartcekur apo shpejtimin e shqyrtimit të neneve të caktuara të këtij ligji, siç edhe ka potencuar Avokati i popullit, në mënyrë që ligji të fillojë së implementuari.

Këto sindikata kanë bërë publike edhe përkrahjen që kanë marrë në këto angazhime nga sindikatat simotra në Evropë.

Mësimdhënësit nga shtete të botës në ceremoninë përkujtimore në Aushvic

Delegacioni i SBASHK-ut mes kolegëve sindikalistë nga 17 shtete të botës

Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) dhe sindikata të tjera nga e tërë bota janë pjesë e një varg aktiviteteve përkujtuese në 75 vjetorin e çlirimit të Kampit të përqendrimit Aushvic. Në këto aktivitete, që kanë filluar me ceremoninë përkujtimore kanë marrë pjesë përfaqësues sindikal të arsimit nga 17 shtete nga e tërë bota. Pjesë e këtij aktiviteti përkujtues janë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe menaxheri për financa e administratë dhe koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut para fillimit të programit zyrtar përkujtues kanë zhvilluar takime me kolegë nga shtete të ndryshme dhe janë takuar edhe me sekretarin e përgjithshëm të EI-së, David Edvards dhe me drejtoreshën për ETUCE, Suzan Flocken

Aktivitetet përkujtuese do të zgjasin 4 ditë dhe janë organizuar nga sindikata ZNP e Polonisë, anëtare e ETUCE në bashkëpunim me Unionin e Mësuesve të Izraelit dhe Sindikatën gjermane të arsimit GEW.

Në ceremoninë zyrtare përkujtimore Sekretari i Përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit (EI), z. David Edvards veç tjerash ka alarmuar se po



jetojmë në një kohë kur racizmi dhe diskriminimi i të gjitha llojeve po shënojnë rritje kudo në botë dhe se sulmet ndaj vlerave themelore demokratike janë bërë të zakonshme. “Jemi këtu bashkë kolegët nga shtete të tërë botës për të mbështetur njëri-tjetrin e për të shkëmbyer ide në mënyrë që gjeneratat e reja të mos harrojnë kurrë dhe të mos përsëritin gabimet e së



kaluarës”, është shprehur Sekretari i Përgjithshëm i EI-së, z. David Edvards .

Edhe drejtorja e ETUCE, Suzan Flocken ka lartësuar kujtimin për viktimat dhe ka kujtuar pastaj se mësimdhënësit kudo janë duhet të mbledhin vazhdimisht forcë dhe të vazhdojnë rrugëtimin për një shoqëri demokratike në kohën kur në Evropë sulmet ndaj vlerave demokratike kanë shënuar rritje.

Ky aktivitet për kujtues do të vazhdojë me mbajtjen e takimeve dhe Konferencave tematike që lidhën me 27 janarin dhe 75 vjetorin e çlirimit të kampit të Aushfic duke lartësuar kështu kujtimin për më shumë se 1 milionë viktima që u persekutuan dhe u vranë në këtë kamp nga forcat naziste.

SBASHK-u botoi revistën “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2019 “

Rrugëtim në një vit plot sfida

Me qëllim që anëtarët e SBASHK-ut kudo në shkollat e Kosovës dhe në njësitë akademike të Universiteteve t'i mbajnë të freskëta kujtimet për ngjarjet e shumta dhe sfidat me të cilat jemi përballur gjatë gjithë vitit 2019, Zyra për informim e sindikatës sonë ka përgatitur dhe ka botuar revistën vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2019” duke vazhduar kështu me traditën e nisur para tri vitesh.

Zyra për informim kishte bërë gjithë përgatitjet dhe kishte veçuar ngjarje të rëndësishme që shënuan vitin 2019. Me kujdes janë zgjedhur edhe foto që ilustrojnë ato ngjarje e angazhime dhe po ashtu u punua shumë edhe në zgjedhjen e qëlluar të dizajnit të kësaj reviste. Kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe

përpilua në vitin 1966 nga pedagogu zviceran Robert Dotterns, për të vazhduar pastaj me një përmbledhje të ngjarjeve sipas muajve.

Duke lexuar revistën lexuesi do të kthejë kujtimet në janarin e vitit të kaluar dhe në grevën që ndodhi në të gjitha institucionet arsimore që nga çerdhet e deri në Universitete. Revista na kthen kujtesën edhe në takimet e shumta me krerët e institucioneve dhe me përkrahjen e ardhur nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës. Vend meritore në këtë revistë tonë ka edhe vizita në shenjë të përkrahjes e drejtores së përgjithshme të ETUCE-së znj. Suzan Flocken në Kosovë dhe takimet e saj me Kryeministrin Hardinaj, Ministrin Bytyqi, me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim, Ismajl Kurteshi, vizita në Shpellën e Gadimes dhe në Shkollën e Gjellbër dhe paraqitja e saj para medieve dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Lexues të nderuar kjo revistë na kthen kujtesën edhe në Manifestimin madhështor në respekt për kolegët tanë të pensionuar e duke shënuar kështu ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe. Nuk janë harruar as aktivitetet në nivel ndërkombëtar e as trajnimet e shumta për anëtarët e SBASHK-ut kudo nëpër komunat e Kosovës .

Janë në këtë revistë edhe shumë nga shërbimet për anëtarësinë duke kujtuar lëndët nëpër gjykata për tri pagat me rastin e pensionimit dhe pagat jubilarë,



të Universiteteve do të marrin ekzemplarë të kësaj reviste dhe do ta dërgojnë nga një në secilën shoqatë sindikale dhe ju anëtarë të nderuar do të keni mundësinë ta lexoni revistën tuaj. Kësaj radhe revistën e kemi filluar me Betimin e mësuesit, që u

por edhe atmosfera në bregdetin shqiptar e krijuar nga 400 pushuesit e dërguar atje në organizim të SBASHK-ut. Kemi sjellë te ju përmes revistës edhe deklarimet e shkurtra të kryesisë dhe stafit të SBASHK-ut lidhur me vitin 2019.

Unifikim i zërit sindikal

Bashkëpunim i sigurtë në përballje me sfidat

Duke vazhduar të jenë zëri i anëtarësisë që përfaqësojnë udhëheqës të SBASHK-ut, FSSHK-së dhe Policisë së Kosovës kanë vazhduar me takime përmbajtësore duke unifikuar zërin sindikal në përballje me sfidat e kohës. Nga këto takime po dalin ide për angazhime të përbashkëta dhe një nga to ishte edhe kërkesa për takime urgjente me Kryeministrin në detyrë z.Ramush Haradinaj, me Kryeparlamentarin z.Glaur Konjufca dhe Avokatin e popullit z.Hilmi Jashari.

Qëllimi i këtyre kërkesave ishte që të tri sindikatat nga Kryeministri në detyrë të kërkojnë që ta dërgoj në Parlament Projektligjin për buxhet për vitin 2020 me qëllim të shmangies së trazirave sociale. Nga Kryeparlamentari të kërkohej që të ndërmarr hapa ligjor parlamentar për aprovimin e buxhetit me kohë. Në takim me Avokatin e popullit do t'i paraqitej kërkesa që të procedoj vullnetin e shprehur me qindra shkresa të sindikatave të punëtorëve në sistemin publik në lidhje me revokimin e vendimit për masën e përkohshme për pezullimin e Ligjit të pagave. Në këto takime të sindikatave është vlerësuar se sfidat me të cilat po përballen të punësuarit në sektorin publik kërkon forcimin e bashkëpunimit mes sindikatave dhe takimet janë një mundësi e mirë për unifikimin e

Duke ju dëshiruar çaste të këndshme në shoqëri me revistën, ju kërkojmë falje nëse është lëshuar ndonjë gabim i vogël drejtshkrimor.



Kërkesë për takim urgjent

Në takimin e përbashkët me mas Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Federatën Sindikale të Shëndetësorëve (FSSHK) dhe Sindikatën e Policisë (SPK) duke parë rrethanat aktuale në të cilat ndodhemi, paraqesim brengën tonë për përfaqësimin e mirëqenies sociale të anëtarësisë tonë dhe të laudër të saj njoftojmë opinionin e gjërë se kërkojmë takim urgjent me Kryeparlamentarin z. Glaur Konjufca, Kryeministrin në detyrë z. Ramush Haradinaj dhe Avokatin e popullit z. Hilmi Jashari.

Te tri sindikatat nga Kryeministri në detyrë kërkojnë që ta dërgoj në Parlamentin e Kosovës Projektligjin për buxhet për vitin 2020 me qëllim të shmangies së trazirave sociale. Ndërsa nga Kryeparlamentari kërkojmë që të ndërmarr hapa ligjor parlamentar për aprovimin e buxhetit me kohë. Avokati i popullit i drejtshkrimi me kërkesën e thyesit që të procedoj kërkesa e sindikatave të punëtorëve të sistemit publik, në lidhje me revokimin e vendimit për masën e përkohshme për pezullimin e Ligjit të pagave.

E gjithë kjo bëhet në përfaqësim të natyrës së qytetësorë sociale në Republikën e Kosovës.

Prishtinë

14.01.2020

Kryetarët:

z. Brahmam Jashari, SBASHK
z. Blelir Sylja, FSSHK
zgj. Valbona Kamberi, SPK

angazhimeve në shërbim të anëtarësisë dhe se bashkërisht është më e lehtë përballja me sfidat dhe arritja e realizimit të kërkesave legjitime të anëtarësisë.

Sindikatat dorëzuan kërkesën e përbashkët në Gjykatën Kushtetuese

Kërkohej revokimi i masës së përkohshme për pezullimin e Ligjit të Pagave

Pas takimit me Avokatin e popullit SBASHK-u, Sindikata e Shëndetësisë, e Policisë, e Doganës dhe ajo e Zjarrfikësve kanë vazhduar me takimet e përbashkëta konsultative me qëllim që të ndërmarrin angazhime të përbashkëta dhe kanë përgatitur kërkesën e përbashkët dorëzuar sot në Gjykatën Kushtetuese me kërkesën që ajo të revokojë masën e përkohshme për pezullimin e Ligjit të pagave.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Për këtë angazhim këto 5 sindikata kanë informuar edhe Avokatin e popullit gjatë takimit me të dhe janë të bindur se Kushtetuesja do ta merr në shqyrtim këtë kërkesë dhe atë që Avokati i popullit e kishte proceduar bazuar në kërkesat e institucioneve arsimore të arsimit, që ishin nënshkruar nga anëtarët e SBASHK-ut dhe ishin dorëzuar në adresën e Institucionit të Avokatit të Popullit.

SBASHK, FSSHK-ja, SPK-ja, Sindikata e Doganës së Kosovës dhe ajo e Zjarrfikësve në takimin e sotëm, krahas aprovimit të kërkesës së përbashkët drejtuar Kushtetueses janë pajtuar që të vazhdohet me takimet konsultative me qëllim që angazhimet të jenë të përbashkëta lidhur me Ligjin e pagave, por edhe për çështje të tjera të rëndësishme për anëtarësinë e këtyre 5 sindikatave, që përfaqësojnë të punësuarit në sektorë shumë të rëndësishëm.

